

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-25-5498-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.N.T KORABI
NUI	810248791
Adresa	Qikatove e Vjeter
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	049393266
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Avdullah Morina
Adresa elektronike	nntkorabi@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	24.11.2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	Taulant Ferizi
Adresa e plotë	Rr. Perandori Justinian ND 1/6, 10000 Prishtinë,
Numri i Telefonit	049614664
Numri i faks-i	
Adresa elektronike t	taulant@ferizilaw.com

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim për Kontratë - 19.06.2025

Leter Standarte (12).pdf - 15.08.2025

VENDIM PER PEZULLIM - NEGROVC.pdf - 21.08.2025

VENDIM - WORLD MEDIUMI.pdf - 01.09.2025

Kerkese për rishqyrtim (9).pdf - 01.09.2025

Leter Standarte - 08.09.2025

VENDIM MBI PEZULLIM - 11.09.2025

VENDIM - NEGROVCI - 15.09.2025

LS - ARLLAT NEGROVC - 18.11.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-se

Neni 7 i LPP-se

Neni 52 i LPP-se

Neni 56 i LPP-se

Neni 59 i LPP-se

Neni 60 i LPP-se

Neni 61 i LPP-se

Neni 64 i LPP-se

Neni 65 i LPP-se

Neni 69 i LPP-se

AUTORIZIM I VEÇANTË**SPECIAL POWER OF ATTORNEY**

Në emër dhe për llogari të:

In the name and on behalf of:

Avdullah Morina B.I.,

me emër tregtar N.N.T. Korabi, me numër unik identifikues të biznesit 810248791, me adresë në Glllogoc, Republika e Kosovës, tutje referuar si "Autorizimdhënësi", unë i poshtënjshkruari Avdullah Morina, me këtë rast emëroj dhe autorizoj:

with trade name N.N.T. Korabi, with business unique identification number 810248791, with address in Glllogoc, Republic of Kosovo, hereinafter referred to as "the Authorizer," I, the undersigned, Avdullah Morina, hereby appoint and authorize:

Taulant Ferizi

avokatë / attorneys-at-law, si dhe / and

Abdyl Lushtaku, Erduan Zariqi, Erion Ferizi dhe Lekë Morina,
bashkëpunëtorë profesionalë / legal associates

me adresë të zyrës në Rr. Perandori Justinian ND 1/6, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për të:

- përfaqësuar kompaninë para të gjitha autoriteteve në Kosovë, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në të gjitha instancat e gjykatave të rregullta të Republikës së Kosovës, përmbaruesit privat dhe çfarëdo institucioni apo agjencie tjetër shtetërore, pranë autoriteteve kontraktuese duke përfshirë por duke mos u kufizuar në dorëzimin e ofertave, parashtrimin e kërkesave për çasje dhe për rishqyrtim, si dhe pranë OSHP-së, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në parashtrimin e ankesave dhe përfaqësimin në seanca pranë OSHP-së.
- t'i kryejë të gjitha veprimet në procedurë, e sidomos të paraqes padinë, ta tërheqë atë, ta parashtrorë përgjigjen në padi, ta pohojë kërkesëpadinë ose të heqë dorë nga kërkesëpadia, të lidhë pajtimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor, të parashtrorë mjetin e goditjes së vendimit si dhe të heqë dorë nga kjo e drejtë apo ta tërheqë mjetin e tillë të parashtruar, por edhe të propozojë caktimin e masave të sigurimit të kërkesave;
- të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative për mbrojtjen dhe përmbarimin e të drejtave dhe interesave të kompanisë, përfshirë këtu parashtrimin e kërkesës për ekzekutimin ose sigurimin dhe të kryejë veprime të nevojshme lidhur me kërkesën e tillë;
- pranuar prej palës kundërshtare shpenzimet procedurale të caktuara nga gjykata;
- udhëhequr procedurat jashtëgjyqësore të çfarëdo lloji në emrin e kompanisë;
- pranuar të gjitha shkresat, përfshirë gjyqësore dhe/apo administrative;
- ndërmarrë të gjitha aranzhimet të cilat i vlerësojnë të dobishme dhe të domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të kompanisë;
- kaluar këtë prokurë te palët e treta.

with registered office at Rr. Perandori Justinian ND 1/6, 10000 Prishtina, Republic of Kosovo, hereby authorizes:

- to represent the company before all authorities in Kosovo, including but not limited to all instances of the regular courts of the Republic of Kosovo, private enforcement agents, and any other state institution or agency, before the contracting authorities, including but not limited to the submission of bids, the filing of requests for access and review, as well as before the PRB, including but not limited to the filing of complaints and representation in hearings before the PRB.
- to perform all procedural actions on behalf of the company, in particular to file lawsuits, withdraw them, submit statements of defense, acknowledge claims or withdraw claims, conclude judicial and extra-judicial settlements, file appeals or other remedies against decisions and, if deemed necessary, withdraw such remedies, as well as to request the imposition of interim or security measures;
- to undertake all legal and administrative actions for the protection and enforcement of the company's rights and interests, including the submission of requests for execution or security measures and to perform any necessary actions related thereto;
- to receive from the opposing party any procedural costs as awarded by the court;
- to conduct extra-judicial proceedings of any kind on behalf of the company;
- to receive all documents, including judicial and/or administrative acts;
- to undertake all arrangements deemed useful and necessary for the protection of the rights and interests of the company;
- to transfer this Power of Attorney to third parties (substitution).

Me nënshkrimin e këtij autorizimi, Autorizimdhënësi pranon që t'i zbulojë plotësisht palës së autorizuar të gjitha faktet, rrethanat dhe provat relevante të tyre lidhur me çështjet për të cilat janë në dijeni.


Upon signing this Power of Attorney, the Authorizer acknowledges and agrees to fully disclose to the Attorney all facts, circumstances, and evidence known to them that are relevant to the matters entrusted under this authorization.

Ky autorizim vlen deri në revokimin apo denoncimin e tij.

This Power of Attorney is valid until its revocation.

Në emër dhe për llogari të Avdullah Morina B.I. / In the name and on behalf of Avdullah Morina B.I.

Nënshkruar me / Signed on



7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor Nr. 1: Deklaratat e inxhinierit Vehbi Goxhuli

Sipas Vendimit të Kontestuar të AK, deklaratat dhe dëshmitë që ka ofruar inxhinieri Vehbi Goxhuli janë baza e eliminimit dhe shpalljes si tenderues të papërgjegjshëm, meqë Operatori Ekonomik ka dërguar të dhëna të rrejshme tek AK. Një konstatim i tillë nga ana e Autoritetit Kontraktues është i pabazuar dhe bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit, të paraparë me Nenin 7 të LPP-së.

Së pari, deklaratat e inxhinierit Vehbi Goxhuli, janë marrë në shkelje të të gjitha dispozitave ligjore dhe vetë përgjegjësisë që bartin në vete këto deklarata. Inxhinieri ka deklaruar se kontrata që ka pasur me Operatorin Ekonomik, ka qenë vetëm për një projekt gjatë vitit 2024, kurse Operatori Ekonomik ka falsifikuar nënshkrimin në kontratën e punës dhe ka keqpërdorur diplomat, CV dhe certifikatat.

Megjithatë, një ndër faktet më të rëndësishme të cilin ky inxhinier nuk e shpërfaq, por që vërtetohet nga Kontrata e Punës, është fakti se kontrata efektin e saj e fillon me datë 17.5.2024 dhe është kontratë në kohë të pacaktuar, që dëshmohet me Nenin 3 të saj, ku thuhet se: *“marrëveshja e kontratës mbi vepër nga data 17.5.2024 deri në kohë të pacaktuar, pra palët kontraktuese u pajtuan që të lidhin marrëveshje në kohë të pacaktuar”*. I njëjti në deklaratat e tij nën betim thekson se kontrata e tij ka qenë vetëm për një projekt, mirëpo nga Kontrata e Punës rezulton se e njëjta është lidhur në kohëzgjatje të pacaktuar, që nënkupton se kontrata do të jetë valide deri në ndërprerje në mënyrë të njëanshme apo me marrëveshje nga Operatori Ekonomik dhe inxhinieri.

Për më tepër, një fakt shumë me rëndësi të cilin e ka fshehur si Autoriteti Kontraktues, ashtu edhe inxhinieri Vehbi Goxhuli, me qëllim që t'i shkaktojnë dëm të pariparueshëm Operatorit Ekonomik është fakti se inxhinieri i ka të paguara të gjitha kontributet pensionale si dhe pagat e tij përmes llogarisë bankare. Pra, inxhinieri është i deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës si punëmarrës me punë sekondare, kurse pagat i paguhen përmes llogarisë bankare, por që thekson se kontrata e tij është falsifikuar.



Lista e Punëtorëve






Periudha	2025		
Numri Fiskal	810246791	Kontakti	AVDULLAH MORINA
Tatimpaguesi	AVDULLAH MORINA B.I.	Adresa	ÇIKATOVË E VJETËR
Regjioni	PRISHTINË 2	Tel	044168205 44118784 44118784
Lloji Kompanisë	Individual	Aktiviteti	Mungon aktiviteti

Nr.	Emri	Nr. identifikues	Primare	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	BEKIM MORINA	1241101025	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
2	ALBIR MUSTAJA	1004060239	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
3	BEKIM MUSTAJA	1232300054	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
4	DIJAN BERISHA	1243672119	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
5	DELLON MORINA	1231410925	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
6	DIJAN MORINA	1176102493	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
7	FELDRETA MORINA	1172100029	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
8	FELDRETA MORINA	1172100029	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
9	FELDRETA MORINA	1244000041	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
10	GETIAR HAJDARAJ	1250831397	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
11	GRESA QALLAJE	1250946275	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
12	HABIB SANONJA	1014602203	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
13	HATIDE MORINA	1015260218	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
14	JAMIR QELA	1231300036	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
15	LAH MORINA	1175380285	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
16	LAJZON DEDAJ	1003707281	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
17	MERISHE MORINA	1171410812	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
18	VITHE GORHULI	1004362503	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
19	WHEMELI CAKOZI	1233300403	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
20	ZIJAH MURATI	1005057932	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

Pyetja më e rëndësishme në këtë rast është, pse Inxhinieri nuk i ka kthyer të hollat në llogarinë e Operatorit Ekonomik, meqë nuk kanë pasur një marrëdhënie kontraktuale, si pasojë e asaj që po pretendohet nga inxhinieri se është pasurim i pabazë. Përgjigjja e kësaj pyetjeje është shumë e thjeshtë dhe e qartë: inxhinieri nuk e ka informuar fare punëdhënësin primar, operatorin ekonomik Ndërtimi Ing Sh.P.K., se është i punësuar në një punë sekondare. Po ashtu, arsyeja tjetër është se ofertues në aktivitetin e njëjtë të prokurimit është operatori ekonomik Eorid Medium Sh.P.K., me aksionar Burim Zabelaj, kurse inxhinieri Goxhuli si punëdhënësin primar sipas Kontratës së Punës ka të regjistruar operatorin Ndërtimi Ing Sh.P.K., me aksionar Shpejtim Zabelaj.

Z. Burim Zabelaj dhe z. Shpejtim Zabelaj janë vëllezër, kurse edhe këto dy kompani, pra World Medium Sh.P.K., dhe Ndërtimi Ing Sh.P.K., selinë e tyre e kanë në të njëjtën adresë, në rrugën Bashkim Gashi pn, Malishevë. Se cila ka qenë tendenca si e Autoritetit Kontraktues, e po ashtu edhe e këtyre operatorëve ekonomik dhe inxhinierit, mund të vërehet nga një vrojtues objektiv i kësaj situate, por që disa nga këta individë do të raportohen pranë organeve prokuroriale për shkak të veprës penale të “deklarimit të rremë nën betim” nga neni 383 i Kodit Penal të Kosovës.

Pra, paraqitja e të dhënave të rreme nga ana e Operatorit Ekonomik – si shkak për eliminim – nuk mund të ekzistojë përderisa të dhënat e prezantuara, në rastin konkret Kontrata mbi Vepër, është e shoqëruar me dëshmi si pagesa e kontributeve pensionale dhe pagesa e shpërblimit përkatës. Për më tepër, pas dhënies së deklaratës vet inxhinieri në fjalë ka kontaktuar përmes Viber dhe ka kërkuar falje, siç shihet në vijim:



Po ashtu, në rastin konkret, elimini i Operatorit Ekonomik dhe shpallja e tij si tenderues i papërgjegjshëm është e pabazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues nuk ka shteruar të gjitha instrumentet juridike të cilat i ka pasur në dispozicion – duke filluar nga kërkesa për informata shtesë. Në ndërlidhje me këtë, neni 59 par. 2 i LPP-së, shprehimisht përcaktohet se: “[a]utoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues”.

Ngjashëm, sipas pikës 38 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), përcaktohet se: “[p]ër të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. ... Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike. 38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohej, ofrohet ose lejohet. 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë. 38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura. 38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së, d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. 38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet. 38.8 "Kërkesën për sqarim të tenderit" AK duhet t'a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik. OE përgjigjen në "Kërkesën për sqarim të tenderit" duhet t'a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik”.

Mungesat e Grupit OE N.T. "Fer Petrol" & MINERAL L.L.C.

1.Kërkesa sipas DT:

“Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master në Drejtimin Infrastrukturë Rrugore (jo bachelor) për Menaxher të Punishtes, i cili kërkohet të ketë minimum 6 vite përvojë pune pas diplomimit. Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të punishtes, menaxheri duhet të posedojë diplomën, çertifikatat origjinale ose kopje, kontratën e punës valide ose të ketë parakontratë ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt. CV-ja e përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar, e nënshkruar nga vet inxhinieri.”

1. Arsytimi: OE ka dorëzuar dy vendime për Menaxher të Projektit, duke emëruar një inxhinier konstruktiv si menaxher projekti dhe një inxhinier të infrastrukturës rrugore, por përsëri si menaxher projekti. Nuk është caktuar menaxher i punishtes siç kërkohet shprehimisht nga DT.

Përfundim ligjor:

Në bazë të Nenit 7 të LPP-së (trajtim i barabartë dhe procedurë e drejtë) dhe Nenit 59 të LPP-së (rishqyrtimi i vendimeve mbi bazën e kriterëve të DT), ky OE nuk i ka përmbushur kriteret e detyrueshme të DT. Sipas Neni 65 pika 4.9 të LPP-së, ofertat që nuk i plotësojnë kriteret duhet të refuzohen. Prandaj, ky OE duhet të eliminohet.

2. Kërkesa sipas DT:

“Ofruesi ekonomik duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master në Drejtimin Konstruktiv, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, dhe të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit, diploma, kontrata e punës valide ose parakontrata, si dhe CV-ja e nënshkruar.”

2. Arsytimi: Për Inxhinierin Karafidin Kuka (i paraqitur si Menaxher Projekti – Drejtimi Konstruktiv), është dorëzuar diplomë e vitit 1988, e lëshuar nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë / Republika Socialiste e Serbisë / Krahina Socialiste Autonome e Kosovës.

Sipas ligjeve aktuale të Republikës së Kosovës, të gjitha diplomat e lëshuara nga ky sistem arsimor duhet të nostrifikohen nga MASHTI për të qenë valide në Kosovë. Ky OE nuk ka dorëzuar vendimin e nostrifikimit, prandaj diploma nuk mund të

konsiderohet e vlefshme për përmbushjen e kriterit.

Përfundim ligjor:

Në bazë të Nenit 65 pika 4 të LPP-së, dokumentet e pavlefshme nuk mund të konsiderohen si përmbushje e kriterëve. Po ashtu, Neni 7 kërkon integritet dhe procedurë të drejtë. Për shkak të mungesës së nostrifikimit, ky OE nuk i përmbush kriteret e kërkuara dhe oferta e tij duhet të refuzohet.

3. Kërkesa sipas DT: Minimum një person i certifikuar për elemente bazë të menaxhimit, zvogëlim të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera, si dhe vlerësim të rreziqeve nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike, me minimum 2 vite përvojë pune.

3. Arsyetimi: OE ka dorëzuar certifikata të lëshuara më 02-04 prill 2025 dhe më 10-11 prill 2025. Këto janë shumë të reja dhe nuk dëshmojnë minimumin prej 2 viteve përvojë pune.

Përfundim: Nuk është respektuar kriteri i përvojës

4. Kërkesa sipas DT: Minimum një person i certifikuar për Menaxher të Repartit Punues sipas ISO 18001:2007 (OHSAS).

4. Arsyetimi: OE ka dorëzuar një person të certifikuar me ISO 45001:2018. Edhe pse ky standard e ka zëvendësuar ISO 18001:2007, në këtë procedurë vlen vetëm kriteri i saktë i përcaktuar në DT.

Përfundim: Nuk është respektuar kriteri i detyrueshëm, pasi nuk është ofruar certifikata sipas ISO 18001:2007.

5. Kërkesa sipas DT: Minimum një person i certifikuar për kontroll të cilësisë së armimit dhe një person i certifikuar për armim.

6. Arsyetimi: OE ka dorëzuar një person të certifikuar si Menaxher Projekti, që nuk është i barasvlershëm me Menaxher të Punishtes, sipas kriterëve të DT.

Përfundim ligjor:

Në bazë të Nenit 5G dhe Nenit 65 të LPP-së, ky OE nuk ka përmbushur kriterin e detyrueshëm dhe oferta e tij duhet të refuzohet.

7. Kërkesa sipas DT:

“Ofruesi ekonomik duhet të ofrojë minimum një (1) kamion për pastrimin e asfaltit me spërkatëse për bitumen dhe emuluzion, duke dorëzuar listën origjinale të pajisjes, si dhe dëshmitë në kopje (librezë, DUD, faturë apo kontratë qiraje).”

7. Arsyetimi:

OE ka ofruar një makineri për pastrim të trotuarit dhe rrugëve (makinë komunale për pastrim), e cila është plotësisht e ndryshme nga pajisja e kërkuar në DT.

Makina e dorëzuar nuk është spërkatëse për bitumen dhe emuluzion, dhe për pasojë nuk përmbush funksionin teknik që kërkon DT.

8. Kërkesa sipas DT:

“Ofruesi ekonomik duhet të ofrojë grejder për rrafshimin e terrenit dhe nivelizimin e tamponit:

minimum 8 t deri maksimum 11 t (1 copë), dhe minimum 15 t deri maksimum 18 t (1 copë).

Për secilën pajisje duhet të ofrohen dëshmitë përkatëse (librezë, DUD, faturë, ose kontratë qiraje.

8. Arsyetimi:

OE ka ofruar një grejder me peshë 13,500 kg, i cili nuk përmbush asnjërin prej kriterëve të përcaktuara në DT:

Mungesat e Grupit OE "AKTIV SH.P.K" & "MURSELI COMPANY SH.P.K"

9. Kërkesa sipas DT:

"OE duhet të dëshmojë se ka të angazhuar një person të certifikuar për elemente bazë të menaxhimit, zvogëlim të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe vlerësim të rreziqeve të lëshuara nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Kërkohet të ketë minimum 2 vite përvojë pune. Duhet të posedojë diplomën, certifikatat, kontratën e punës ose parakontratën."

9. Arsyetimi:

Ky OE ka dorëzuar vetëm një certifikatë për zvogëlim të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, e cila nuk është lëshuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Gjithashtu, nuk është dorëzuar fare certifikatë për vlerësim të rreziqeve, ndërkohë që DT kërkon dy certifikime të ndara.

Përfundim ligjor:

Në bazë të Neni 65 pika 4.G të LPP-së, ky OE nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara në DT. Oferta duhet të refuzohet.

10. Kërkesa sipas DT:

"Minimum një person të certifikuar për Menaxher të Repartit Punues i cili është trajnuar dhe certifikuar në bazë të parimeve të ISO 18001:2007, inspektor zbatues i sistemit OHSAS 18001 për punëtorët në vendpunishte."

10. Arsyetimi:

Ky OE ka dorëzuar një certifikatë për siguri dhe shëndet në punë, e cila nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DT. Në certifikatë nuk përmendet askund standardi ISO 18001:2007 apo OHSAS 18001 siç kërkohet.

Përfundim ligjor:

Sipas Neni 59 dhe Neni 65 të LPP-së, dokumentet që nuk janë konform kërkesave të DT janë të pavlefshme. Ky OE nuk e përmbush kriterin dhe oferta duhet të refuzohet.

11. Kërkesa sipas DT:

“Minimum një person të certifikuar për manipulues të makinerive të rënda.”

11. Arsyetimi:

OE ka dorëzuar një certifikatë vetëm për Eskavator, e cila nuk mbulon kualifikimin e përgjithshëm të kërkuar për “manipulim të makinerive të rënda”. DT kërkon trajnim më gjithëpërfshirës për këtë kategori.

12. Kërkesa sipas DT:

“Minimum një person të certifikuar për manipulues të makinerive të rënda.”

12. Arsyetimi:

OE ka dorëzuar një certifikatë vetëm për Eskavator, e cila është shumë e ngushtë dhe nuk mbulon kualifikimin e përgjithshëm të kërkuar për “manipulim të makinerive të rënda”. DT kërkon trajnim më gjithëpërfshirës për këtë kategori.

13. Kërkesa sipas DT:

“OE duhet të paraqesë raportin e vlerësimit të riskut në vendet e punës, të hartuar nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Siguri dhe Shëndet në Punë. Duhet të bashkëngjitet edhe kopja e licencës së kompanisë së licencuar.”

13. Arsyetimi:

Në këtë konsorcium, kompania “MURSELI COMPANY SH.P.K” nuk ka ofruar fare raport të vlerësimit të rrezikut, ndonëse ky dokument është i detyrueshëm.

14. Kërkesa sipas DT:

“OE duhet të dëshmojë se ka të angazhuar minimum një person të certifikuar për kontroll të cilësisë së armimit dhe minimum një person të certifikuar për armim.”

14. Arsyetimi:

Ky OE nuk ka dorëzuar asnjë certifikatë për kontroll të cilësisë së armimit. Edhe pse mund të ketë persona të certifikuar për armim, kërkesa për kontroll cilësie ka qenë kriter i veçantë dhe i detyrueshëm.

Pretendimi Ankimor Nr. 15: Inxhinieri i Komunikacionit Ermira Gashi nuk e ka përvojën e kërkuar të punës

Në Dosjen e Tenderit në kriteret “Kapaciteti teknik dhe profesional” është kërkuar që: “OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master drejtimi komunikacion (ose bachelor), kërkohet të ketë min. 6 vite përvojë punë – angazhime profesionale pas diplomimit”. Në rastin konkret, inxhinierja Ermira Gashi, nuk ka përvojë punë gjashtë (6) vjeçare pas diplomimit në programin master të “Komunikacionit rrugor”. Pas përfundimit të studimeve bachelor, e njëjta ka marrë titullin “Bachelor i Inxhinierisë Mekanike”. Përvoja e punës është dashur të kalkulohet që nga diplomimi në programin master të komunikacionit rrugor, gjegjësisht nga data 07.04.2023, kur e njëjta e ka mbrojtur temën e diplomës në studimet master.

Megjithatë, edhe nëse përvoja gjashtë (6) vjeçare e punës do të llogaritej nga data 21.06.2019 (data e diplomimit nga studimet bachelor), e njëjta nuk e ka përvojën e punës, për atë arsye edhe nuk është kërkuar nga AK përvoja e punës e dëshmuar me anë të pasqyrës së trustit, me qëllim të favorizimit të këtij grupi operatorësh.

Në CV e inxhinieres, theksohet se e njëjta ka “punuar”, gjatë vitit 2018-2019 si Bachelor i Komunikacionit tek kompania NNT Burimi. Megjithatë, e njëjta ende as nuk ka përfunduar studimet deri në qershor 2019, andaj edhe nuk është konsideruar si Bachelor i Komunikacionit. Poashtu, në Referencën e lëshuar nga NNSH World Medium, theksohet se kjo inxhinierë ka qenë e angazhuar si praktikante nga fillimi i vitit 2019, e më pastaj edhe si eksperte e jashtme e mbikqyrjes. Nga Tabela e bashkëngjitur në këtë referencë, shihet

qartë se inxhinierja ka filluar mbikqyrjen e projekteve në vitin 2022, andaj edhe CV e saj është e përfshirë në shumë kontradikta dhe kundëthënie në raport me referencat e bashkëngjitura, e që është e qartë se e njëjta nuk plotëson as për së afërmi kriterin e përvojës prej gjashtë (6) vitesh, siç kërkohet me dosjen e tenderit. Për të shtuar edhe më shumë dilemat lidhur me përvojën e saj të punës, është bashkëngjitur kontrata e punës, e cila është lidhur me datë 21.11.2024, që bie në kundërshtim me CV e nënshkruar nga vet inxhinierja.

Andaj, ky pretendim ankimor i OE Ankues është i bazuar, ashtu që kërkojmë që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim dhe të kërkohet pasqyra e trustit që të dëshmohet përvoja e kësaj inxhinierie.

Pretendimi ankimor Nr. 16: Mbështetja bankare e ATC SH.P.K., dyshohet të jetë e falsifikuar dhe nuk plotëson as kriterin e kërkuar

GOE Fitues ka ofruar Letër Mbështetjen Bankare, të datës 21.07.2025, të lëshuar nga TEB Bank për ATC Sh.P.K. Megjithatë, dyshojmë se kjo letër mbështetje nuk është lëshuar nga banka në fjalë për arsyet si në vijim:

Nga letra e mbështetjes e lëshuar nga Banka Komerciale TEB Bank, ekzistojnë disa anomali të cilat lënë për të dyshuar se dokumenti në fjalë është i falsifikuar.

- Dokumenti, në tërë përmbajtjen e tij, është asimetrik sa i përket logos së dokumentit, adresës së institucionit dhe tekstit brenda këtij dokumenti.
- Ekziston një mos-përputhje e dukshme ndërmjet pjesës së tekstit dhe pjesës qenësore të dokumentit – nënshkrimit, vulës, emrit dhe mbiemrit të zyrtarit të institucionit (kjo mund të ndodhë në rastet kur nënshkrimi dhe vula janë lëshuar për një dokument tjetër, por janë bartur tek dokumenti i kontestuar).
- Nga një selektim i thjeshtë i tekstit mund të vërehet se pjesët më të rëndësishme të tekstit nuk selektohen (kjo mund të ndodhë në rastet kur ka pasur ndërhyrje në dokument; rrjedhimisht ekziston ky dallim i formatimit).
- Në të njëjtin dokument, i cili supozohet se është lëshuar nga një institucion bankar serioz, gjenden rreth tre (3) forma të ndryshme të stilit të tekstit (fonte). Adresa, emri dhe mbiemri i zyrtarit, si dhe pjesa tjetër e tekstit, dallojnë ndërmjet vete sa i përket stilit të shkrimit (fontit) dhe madhësisë së tekstit.

Në bazë të argumentimit të mësipërm, bëjmë me dije se dokumenti i mësipërm, për nga dukja e tij, lë hapësirë të dyshohet se është i falsifikuar apo se ka pasur ndërhyrje në të.

Për më tepër, edhe nëse ky dokument është lëshuar nga banka në fjalë, këto kredi janë të aprovuara paraprakisht dhe nuk ka informacion nëse të njëjtat janë shfrytëzuar apo jo. Andaj, kërkojmë që pretendimi ynë ankimor të aprovohet, dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Pretendimi ankimor Nr. 17: Marrëveshjet për Qera të Makinerive nuk plotësojnë kriteret e Dosjes së Tenderit.

Marrëveshja për Qiramarrje të pajisjeve dhe makinerive e nënshkruar në mes të World Medium dhe Ndërtimi Ing, Kosova Asfalt Sh.P.K., si dhe Quality Asfalt nuk theksojnë farë se cilat pajisje janë duke u marrë më qera, por vetëm theksohet se do të mirren pajisje me qera. Përderisa nuk theksohet se cilat pajisje do të kontraktohen, kriteri i përcaktuar në dosjen e tenderit, nuk plotësohet në asnjë mënyrë.

Pretendimi ankimor Nr. 4: Eskavatorët janë në pronësi të Raiffeisen Leasing Eskavatorët prej 24t, të prezantuar si në pronësi të Rahovica Commerce, janë në pronësi të Raiffeisen Leasing, dhe për ta nuk është prezantuar asnjë dëshmi pagese e tyre, apo ndonjë dëshmi tjetër për kalimin në pronësi apo shfrytëzim më qera në mes të Rahovica Commerce dhe Raiffeisen Leasing.

Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar në tërësi.

Pretendimi ankimor Nr. 18: Pajisjet e prezantuara në pronësi të Rahovica Commerce Sh.P.K., janë në pronësi të N.N.T. Rahovica Commerce

Pajisjet: Eskavator Kamatsu 15t, Ngarkues/Eskavator i përdorur 13.5t, janë në pronësi të N.N.T. Rahovica Commerce, e cila figuron si biznes i shuar, kurse Rahovica Commerce Sh.P.K., nuk ka kontratë qeraje më këtë biznes. Përveç nëse kemi të bëjmë me ndryshim të llojit të biznesit nga biznes individual në shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, pretendimi ynë ankimor është i bazuar, në mungesë të kontratës së qerasë në mes të Rahovica Commerce Sh.P.K., dhe N.N.T. Rahovica Commerce B.L.

Pretendimi ankimor Nr. 19: GOE Fitues nuk ka prezantuar Cilinder për ngjeshje të zhavorit min. 10t deri max. 15t (2 copë)

- (a) HAMM Cilindri me dhembeza, me peshë 12.2 ton – për të cilin fatura është e lëshuar nga Fitorja sh.p.k., për Rahovica Commerce Sh.P.K., nuk ka fletëpagesë të bashkëngjitur, siç kërkohet me dosjen e tenderit. Në fakt, ekziston një fletëpagesë bankare, mirëpo përshkrimi i saj është: “pagesë për profatura 11/24 dhe 12/24” në vlerë prej EUR 170.000.00, kurse Fatura Tatimore me të cilën është shitur Cilindri në fjalë mbanë numrin 0017-29/24. Pra, GOE Fitues nuk ka paraqitur fletëpagesë, edhe pse në dosjen e tenderit parashihet se: “Paisjet duhet te jene me Libre, DUD ose **Fatur te bashkangjitur edhe deshmia bankare e pageses**”;
- (b) Cilindri Amann AC 110, me peshë 11.6 ton – për të cilin ekziston një faturë e lëshuar nga Visco Sh.P.K., për Kosova Asphalt Sh.P.K., por nuk ka të bashkëngjitur transaksion bankar;
- (c) Cilindër HAMM 3412, me peshë 12 ton, por për të cilin nuk ka transaksion bankar të bashkëngjitur, të paguar nga Kosova Asphalt (qiradhënës I Eorla Medium);

Rrjedhimisht, ky pretendim është i bazuar në tërësi, pasi që për këto pajisje nuk janë bashkëngjitur fare transaksionet bankare.

Mungesat e Grupit OE “WORLD MEDIUM & ATC COM & ADEA CONSTRUCTION & RAHOVICA COMERCE”

Pretendimi ankimor Nr. 20:

Arsyetim

Në marrëveshjen e konsorciumit të dorëzuar:

WORLD MEDIUM është lider me **60%**, **ATC**

COM ka **20%**,

ADEA CONSTRUCTION ka **10%**,

RAHOVICA COMERCE ka **10%**.

Dokumenti i dorëzuar për mbështetje bankare në vlerë 200,000 € është lëshuar vetëm për **ATC COM SH.P.K.** (20%).

Vlera totale e tenderit:

Vlera e projektit është **700,000 €**.

Mbështetja bankare e kërkuar është **200,000 €**, që përbën rreth **28.57%** të vlerës së kontratës ($200,000 \div 700,000 \times 100$).

Pra, për të garantuar kapacitet të mjaftueshëm financiar, OE ose konsorciumi duhet të demonstrojë që mbështetja bankare është **proporcionale me përgjegjësinë e tij në projekt**, ose të jetë **në emër të liderit** që mban barrën kryesore.

Struktura e konsorciumit sipas marrëveshjes:

WORLD MEDIUM – 60% ? përgjegjësi për ~420,000 € të kontratës.

ATC COM – 20% ? përgjegjësi për ~140,000 € të kontratës.

ADEA CONSTRUCTION – 10% ? përgjegjësi për ~70,000 €.

RAHOVICA COMERCE – 10% ? përgjegjësi për ~70,000 €.

Dokumenti i ofruar nga OE:

Mbështetja bankare prej **200,000 €** është dorëzuar vetëm nga **ATC COM (20%)**.

Përgjegjësia financiare e ATC COM në këtë projekt është vetëm **140,000 €**, ndërsa dokumenti bankar tejkalon jo vetëm përqindjen e tij, por krijon edhe **paqartësi juridike dhe financiare**:

Si mund të garantojë një anëtar me 20% përgjegjësi, mbështetje bankare që përbën gati 50% të pjesës së liderit ?

Përfundimi final:

Ky konsorcium **nuk i ka përmbushur kriteret financiare** të përcaktuara në DT.

Dokumenti bankar nuk është i vlefshëm sipas strukturës së konsorciumit, pasi është dorëzuar nga një anëtar jo-lider me vetëm 20% pjesëmarrje, dhe nuk siguron mbështetje proporcionale.

Në bazë të Nenit 7, 56 dhe 65 të LPP-së, oferta e këtij OE duhet të refuzohet.

21.Kërkesa sipas DT:

"OE duhet të ofrojë minimum një (1) cisternë uji autobode, me dëshmitë përkatëse (librezë, DUD, faturë ose kontratë qiraje)."

21.Arsyetimi:

OE ka dorëzuar një librezë automjeti ku shënohet "kamion cisternë".

Ky term tregon një automjet të përgjithshëm transportues të lëngjeve, i cili nuk është i njëjtë me cisternën e specializuar autobode për ujë që është kërkuar në DT.

Pra, dokumenti i ofruar nuk përmbush kriterin e saktë të përcaktuar.

22.Kërkesa sipas DT:

"OE duhet të ofrojë minimum 8 (tetë) kamionë kiper, me dëshmitë përkatëse (librezë, DUD, faturë ose kontratë qiraje). Kamionët kiper shërbejnë për bartjen e zhavorit dhe materialeve ndërtimore."

22.Arsyetimi:

Ky OE ka ofruar 8 kamionë kiper 7 janë në përputhje me kriteret e DT,

- por 1 kamion, sipas librezës, është kamion i rëndë kiper me peshë 26,000 kg dhe kapacitet ngarkese vetëm 1,415 kg.
- Një kapacitet i tillë nuk është i përshtatshëm për bartjen e zhavorit ose asfaltit, që është përdorimi tipik dhe i kërkuar për kamionët kiper në projektet rrugore.

Pra, edhe pse numri formal prej 8 është plotësuar, kriteri nuk është përmbushur, pasi një prej automjeteve nuk është funksional për qëllimin e parashikuar në DT.

23.Kërkesa sipas DT:

“OE duhet të paraqesë një listë prej së paku minimum 10 punëtorë, të shoqëruar me

kontratat e punës ose parakontratat, të gjitha të nënshkruara dhe të vlefshme.”

23.Arsyetimi:

Në këtë konsorcium, kompania RAHOVICA COMERCE SH.P.K. ka paraqitur vetëm një listë të punëtorëve, por nuk ka bashkëngjitur kontratat e punës apo parakontratat për asnjërin prej tyre. Sipas DT, lista pa kontrata nuk konsiderohet e mjaftueshme dhe nuk dëshmon kapacitetin real të stafit.

24.Kërkesa sipas DT:

“OE duhet të ketë minimum një person të certifikuar për Menaxher të Repartit Punues, i cili është trajnuar dhe certifikuar në bazë të parimeve të ISO 18001:2007, inspektor zbatues i sistemit 18001 OHSAS për punëtorët në vendpunishte. Duhet të dorëzohen diploma, certifikata, kontrata e punës ose parakontrata, dhe CV-ja përkatëse.”

24. Arsyetimi:

Ky OE ka dorëzuar dokumentacion për personin Syl Derguti.

Kontrata e punës e bashkëngjitur është me kompaninë RAHOVICA COMERCE, por është e lidhur më datë 03.01.2020 deri më 31.12.2021 (kontratë njëvjeçare). Kjo kontratë ka skaduar prej më shumë se 3 vitesh dhe nuk dëshmon angazhim aktual të punonjësit. Certifikata e bashkëngjitur, me numër serik të verifikueshëm në faqen zyrtare të KingCert International, figuron si ANULUAR / SUSPENDUAR, pra nuk është valide.

Në këtë mënyrë, ky OE ka dorëzuar dokumente të pavlefshme, gjë që përbën shkelje ligjore në kuadër të procedurave të prokurimit publik.

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

KONTRATË PUNE PËR KOHË TË CAKTUAR

Neni 1

Me këtë Kontratë: **“Rahovica Commerce” SH.P.K.** rr. A.Kaqiku p.n.me nr. Biznesi - 810165903, të cilin e përfaqëson: pronari-drejtori Fehmi Krasniqi, me nr. Personal 2005085457, (në tekstin e mëtejme: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me:

Syl Derguti, i lindur me 26/02/1997, në Zwiesel, me nr.personal 1244435595, nga fsh.Varosh Komuna Ferizaj, i pa kualifikuar, shtetas i Kosoves(në tekstin e mëtejme: I punësuari).

Neni 2

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: ***Menagjer i repartit punues Officer18001 : 2007 inspektorZbatues i sistemit 18001OHSAS per punëtorët në vendpunishte për të qenë konform me kërkesat që dalin nga aspekti i sigurisë në punë.***

Neni 3

I punësuari do të kryejë punët në: në vendpunishten e ndërmarrjes, që gjendet në magjistralën Prishtinë –Shkup dhe në vendpunishtet e kontraktuara nga “Rahovica Commerce” SH.P.K.

Neni 4

I punësuari e vazhdon marrëdhënien e punes, në:

- 1) kohë të caktuar, duke filluar nga:03.01.2020, deri më:31.12.2021, kontratë 1 vjeqare.

Neni 5

I punësuari e vazhdon marrëdhënien e punë sipas kontratës së mëparshme.

Në rast se i punësuari nuk e vazhdon punën sipas kësaj Kontrate të Punës, do të konsiderohet se e ka e ka shkëputur marrëdhënien e punes, përveç nëse është penguar të fillojë punën për shkaqe të arsyeshme.

Neni 6

Puna provuese e të punësuarit zgjat deri më:-----, Gjatë periudhës provuese të punës, punëdhënësi dhe i punësuari, mund ta ndërpresin marrëdhënien e punës, me njoftim paraprak prej shtatë (7) ditësh.

Neni 7

I punësuari themelon marrëdhënie pune me orar të plotë. Orari i plotë gjatë ditës, është: 8 orë punë efektive, ndërsa në javë i bie 40 orë pune efektive.

Neni 8

Të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi prej: 250€ (euro), së paku një herë në muaj e cila pagë nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale.



CERTIFICATE

This is to certify that the person mentioned here below
Aşağıda adı geçen

SYL DËRGUTI

KingCert International Certification DOO
Has attended the program with EN ISO/IEC 17024 accredited by WAS
WAS tarafından EN ISO/IEC 17024 standardına göre akredite edilmiş
KingCert International Certification DOO
Tarafından Gerçekleştirilen

OHSAS 18001:2007
Occupational Health and Safety
Management Systems Internal Auditor

OHSAS 18001:2007
İş Sağlığı ve Güvenliği
Yönetim Sistemi İç Denetçi

Organized by KingCert International Certification DOO and in the end of the training program has been
awarded with this certificate.
Eğitime katılmış ve eğitim sonrasında bu belgeyi almaya hak kazanmıştır.

Training Dates / Eğitim Tarihleri: 21-23.05.2018

Held In / Eğitim Yeri: Prishtina - Kosovo

Certificate Number / Sertifika Numarası: 18051121



World Accreditation Services
ACCREDITED
CERTIFICATION BODIES
EN ISO/IEC 17024
CERTIFICATION OF PERSONS

KingCert International Certification DOO
Bandzovo Brdo, Ul. Rifat Burdžević.
Bb. 84310 Rozaje Montenegro
info@KingCert.me
FR.25. / 01.09.2017 / -- / 00


KingCert International Certification DOO
Trainer


KingCert International Certification DOO
General Manager

The validity of the certificate can be checked through www.KingCert.me and www.TheWas.us KingCert International Certification DOO will accept responsibility for major
neglects although the required care and competency was provided. The certificate is property of KingCert International Certification DOO and shall be returned if requested.



Certificate Search



I'm not a robot



SEARCH CERTIFICATE

RESET

Categories

- System Certification
- CE & Product
- Training Services

Some Standards

- ISO 22000:2018 Food Safety Management System Lead Auditor Training
- ISO 22301:2019 Business Continuity Management System
- ISO 14001:2015 Environmental Management System
- ISO 22301:2019 Business Continuity Management System Lead Auditor Training
- ISO 37001: 2016 Anti-Bribery Management System Lead Auditor Training

TITLE

STANDARD

ACCREDITATION

CERTIFICATE ID

TRAINING START DATE

01.01.1970

DATE

TRAINING END DATE

01.01.1970

TRAINING TIME

hour

TRAINING PLACE

CERTIFICATE STATUS

Suspended or Cancelled

Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nga eliminimi i padrejtë, kompanisë sime N.N.T. KORABI i janë shkaktuar dëme materiale dhe profesionale, duke filluar nga humbja e mundësisë për të realizuar një kontratë publike me vlerë të konsiderueshme, shpenzimet e kryera për përgatitjen e ofertës dhe dokumentacionit të nevojshëm, deri te angazhimi i panevojshëm i stafit dhe kohës së kompanisë. Për më tepër, ky vendim ka cenuar reputacionin profesional dhe besueshmërinë e kompanisë përballë institucioneve publike dhe operatorëve të tjerë ekonomikë.

8. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit".*
- b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderues të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

Kësisoj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të marrë këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE N.N.T. Korabi, (Avdullah Morina B.I.);
- II. **ANULOHET** Vendimi për shpalljen fitues të N.N.SH Eorl Medium, ATC Sh.P.K., Adea Construction Sh.P.K., dhe Rahovica Commerce Sh.P.K., dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim;

*Avokat - M. Morina at law
TALLAT PERIZI
Antep, 01/02/2019, 11:00
Tel: 068 811 500, 068 811 600
d.m.m. (antep) (antep) (antep)*